



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / РЕПУБЛИКА КОСОВА	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS МИНИСТАРСТВО ЖИВОТНЕ СРЕДИНЕ, ПРОСТОРОНОГ ПЛАНИРАЊА И ИНФРАСТРУКТУРЕ MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia.org Org.Jedinita Org.Unit	SP-02
Nr.i Faqeve Br. Stranica No.Pages	03
Nr.i Prot. Broj Prot. Prot. No.	649-2/24
Data: Datum: Date:	11.08.25
PRISHTINË / A	
No.1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	04.08.2025
REFERENC-Ë:	24/649/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Durimi" Sh.p.k. Vasilevë, Drenas
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 24/649/79/ DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi Përfundim Procedure administrative të kërkesës së Kompanisë "Durimi" Sh.p.k. Vasilevë, Drenas, për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në vendburimin në Strazhë, Komuna Novo Bërdë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Përfundimi i procedurës administrative i kërkesës së Kompanisë "Durimi" Sh.p.k. Vasilevë, Drenas, për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në vendburimin në Strazhë, Komuna Novo Bërdë.

A r s y e t i m

Komisioni për Vlerësim të Raporteve të VNM-së ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të Kompanisë "Durimi" Sh.p.k. Vasilevë, Drenas, dhe gjatë shqyrtimit të Kërkesës, raportit të VNM-së si dhe dokumenteve përcjellëse të Kompanisë është konstatuar se mungojnë informatat si në vijim:



- Pëlqimi i Komunës nuk ka qartësuar se a lejohet të zhvillohet aktiviteti për të cilin është aplikuar në ngastrën kadastrale nr. P-72403058-00673-1; dhe
- Në Raportin e VNM-së nuk sqarohet se a ak të bëjë me kërkesën për zgjerim të fushës së shfrytëzimit, apo ka të bëjë me një aktivitet të ri.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, "Durimi" Sh.p.k. Vasilevë, Drenas me datën 02.06.2025 i është dërguar njoftimi për plotësim dokumentacioni.

Kompania në fjalë nuk ka sjellë informatat shtesë brenda afatit të përcaktuar kohorë.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr **Vendim për Përfundim të Procedurës administrative** të kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Durimi" Sh.p.k. Vasilevë, Drenas, për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në vendburimin në Strazhë, Komuna Novo Bërdë.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Vërejtje: Afati i paraparë për shqyrtim të lëndës është tejkaluar për shkak të vëllimit të madh të kërkesave, si dhe për shkak të ndryshimit të disa antarëve të komisionit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/649/ - ZSP/ /25 datë: 04.08.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Novo Bërdës
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

Faqe 3 nga 3